



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM
PËR SHPREHJE INTERESI PËR KOMANDIMIN E 4 (KATËR)
PROKUROREVE PRANË INSPEKTORIT TE LARTE TE DREJTESISË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me nenet 53/2, 54 dhe 55 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 176/3 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në bazë të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë me shkresën Nr.4 Prot datë 29.01.2020, vendosi fillimin e procedurave për komandimin e 4 (katër) prokurorëve në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli fton të gjithë prokurorët e Republikës së Shqipërisë të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar,
- kanë jo më pak se 13 vjet përvojë pune në funksionin e prokurorit,
- nuk kanë masë disiplinore në fuqi,
- janë vlerësuar “shumë mire” në dy vlerësimet e fundit,
- nuk janë të komanduar në ndonjë pozicion tjetër,

të shprehin interesin për t’u komanduar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimin brenda datës **19 Shkurt 2020, ora 16.00**, në adresën si në vijim:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa” Nr. 1 Tiranë.

Kërkesa për shprehjen e interesit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4).
2. CV- në e kandidatit.

Mbi zarf duhet të shënohet: “Shprehje Interesi për Komandim (si Inspektor) pranë ILD”.

Mirëpresim aplikimet Tuaja!